



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsioni dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë, nr. 12/20019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror (KSHPK) në vazhdimin e seancës 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-5547 nga viti 2019, formuar pas denoncimit nr. 12-5547/1 me datë 10.12.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshm për lëndën me numër 12-5547 nga viti 2019, në rastin e lëndës vepron organ tjetër kompetent

Lënda me numër 12-5547 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të deperosnalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e vendimmarrjes.

Sqarim

Lënda me numër 12-5547 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit me numër 12-5547/1 me datë 10.12.2019 deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga

Në denoncim janë theksuar akuza kundër personave dhe, ish drejtor dhe drejtor i gjimnazit "....." në Kërçovë, për parregullsi në punën e tyre dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe funksionit.

Në denoncimin e dorëzuar janë numëruar disa akuza paushale, të cilat parashtruesi i thekson sipas njohurive të veta dhe akuza që i ka ndëgjuar nga persona tjerë, për keqpërdorimet e bëra nga ana e personave të denoncuar derisa kan kryer detyrën e drejtorit në gjimnazin, dhe atë: keqpërdorim të mjeteve për mirëmbajtje të gjimnazit; parregullsi në shpërndarjen e profesorëve nga një shkollë në shkollë tjetër të mesme në bazë të plotësimit të fondit të orëve; keqpërdorim i mjeteve nga fondi i orëve private të cilët i kan mbajtur profesorët kurse të hollat i ka fituar shkolla; parregullsi gjatë emërimit të ndihmës drejtorit; shpërndarje jologjore e kontabilistëve në shkollë; tolerimi i mungesës me pagesë të profesorëve të cilëve iu paguhet rroga kurse mungesën e tyre e kanë shfrytëzuar për punë jashta vendit; parregullsi në llogaritjen e fondit të orëve të kontabilistit; sistematim të pa bazë të ish drejtorit në vendin e punës si bibliotekist pas mbarimit të mandatit në shkollën e njëjtë në të cilën nuk është paraparë si i atillë dhe borxh i madhë i shkollës i bërë gjatë kohës së tyre si drejtorë. Denoncimi i dorëzuar

është kahëzuar kah Prokuroria publike në dhe kërkohet të bëhen procedura gjyqësore kundër akuzat e lëndës, kurse në denoncim është theksuar se i njëjti denoncim do të dorëzohet deri tek KSHPK, kryeministri dhe deri në MPB – polici.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merr parasyshë akuzat e parashtrusit në drejtim të caktimit të gjendje faktike, dorëzoi kërkesë deri në Prokurorinë Themelore për mbledhje të të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve në lidhje me akuzat e lëndës.

Në lidhje me kërkesën e dorëzuar, me datë 19.05.2019, është marrë përgjigje me të cilën KSHPK lajmërohet se deri në Prokurorinë themelore publike nga ana e kundër dhe, ish drejtor dhe drejtor i gjimnazit në Kërçovë janë dorëzuar disa kallëzime penale me të cilat janë formuar më tepër lëndë. Në kallëzimet penale të dorëzuara parashtruesi denoncon parregullsi në punën e drejtorëve në lidhje me pagesën e rrogave, punësimeve, miratimit të pushimit pa pagesë dhe të tjera. Duke vepruar për kallëzimet penale të dorëzuara nga ana e kësaj prokurorie janë ndërmarrë më tepër veprime me qëllim që të caktohet se vallë në veprimet e të denoncuarve ekzistojnë vepra penale dhe për atë qëllim nga ana e tyre janë dorëzuar më tepër kërkesa për lajmërimet deri në institucionet kompetente – deri në Shkollën e mesme komunale ”.....”, MPB Kërçovë dhe Inspektorati shtetëror i arsimit. Nga ana e kësaj prokurorie është gjetur se veprat e bëra nuk janë penale për të cilat duhet të padite nëpërmjet detyrës zyrtare. Ajo çka ka të bëjë me kërkesa e dorëzuar – denoncimi i të dëmtuarit për të cilën KSHPK kërkon informacione, informohet se para PTHP ende është në proces mbledhja e dëshmimeve nga ana e kësaj prokurorie dhe pasi që të mblidhen të gjitha dëshmitë do të merret vendimi i duhur i prokurorisë publike për të cilën i dëmtuari do të jetë në kohë i informuar.

Në bazë të kësaj të tërë të konstatuarës më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korupsionit vërtetoi se në rasti e lëndës veprojnë organe tjera kompetente PTHP para të cilës procedura ende vazhdon, me çka vlerësoi se Komisioni shtetëror nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në rastin e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror përparandalim të korupsionit vendosi si në dipozitë tëkëtij vendimi.

Është vendosur me datë 14 Dhjetor 2020, me nr. 12-1913/3

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi
Pas mbarimit të KSHPK
Punoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: S.P.D., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
Kryetar: Biljana Ivanovska